



QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

RAPORT VJETOR
për realizimin e Programit për zhvillim të
rajonit planor Jugperëndimor
për vitin 2018

Janar 2019

HYRJE

Programi për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor është dokument afatmesëm, i cili bazohet në të drejtën ligjore tek Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (neni 12-14), qëllimi i tij është zvogëlimi i dispariteteve mes rajoneve planore, si edhe në vetë rajonin, dhe të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm përmes shfrytëzimit të të gjithë potencialeve të cilat janë dispozicion.

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetorë bëhet përmes Planin Aksionar, ku realizimi i tij është bazik për arritjen e qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në Programi për zhvillim të rajonit planor, gjegjësisht në zhvillimin ekonomik, infrastrukturë, zhvillimin rural, turizëm dhe kulturë, arsimore dhe sociale dhe aspekte të tjera të zhvillimit të RPJP.

Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor, në përputhje me dispozitat ligjore, duke respektuar praktikat e përgjegjshmërisë dhe transparencës për veprimtarinë e saj, Qendra përgatit Raportin vjetor si në vijim për zbatimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2018.

Në raport, projektet dhe aktivitetet janë të lidhura drejtpërdrejtë me qëllimet afatmesëm, prioritetet dhe masat nga Programi për zhvillim, si dhe me treguesit për nivelin e realizimit të këtij dokumenti bazik në vitin aktual. Raporti vjetor është konceptuar në katër pjesë, secila pjesë përmban aktivitete të realizuara nga projektet në përputhje me qëllimet afatmesme.

Në raportin vjetor, përveç pjesës narrative janë vendosur të detajuara edhe qëllimet afatmesme përkatëse, prioritetet, masat, treguesit dhe rezultatet dalëse, si dhe një përmbledhje e tyre tabelore.

Vlen të theksohet se aktivitetet e paraqitura kryesisht realizohen nga Qendra për Zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor, por edhe nga komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor, si dhe nga sektori joqeveritarë dhe i biznesit.

Shumica e aktiviteteve financohen përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë për Zhvillim Rajonal, Programit për zhvillimin rural të agjencisë për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe nga donatorë të huaj BE, UNDP dhe të tjerë.

Të gjithë aktorët së bashku kontribuojnë në realizimin e Programit për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor dhe kështu japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e rajonit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve.

Qëllimi afatmesëm 1

Ekonomi moderne rajonale e bazuar në teknologji të lartë dhe njohuri

1. Biznes Qendra për mbështetje dhe shërbime për sektorin e biznesit

Gjatë periudhës raportuese, sektori i NVM-ve u informua për publikimet e Fondit për Inovacionin dhe Zhvillimin Teknologjik në pjesën e mundësive për marrjen e granteve me bashkëfinancim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kanë tendencë rritje të shpejtë ("Gazeli"); Grantet me bashkëfinancim për mikro ndërmarrjet; Grantet me bashkëfinancim për të përmirësuar inovacionin dhe grantet me bashkëfinancim për trajnimin dhe praktikën profesionale për të rinjtë e sapo punësuar.

Në bashkëpunim me Odat rajonale të tregtisë të Kërçovës dhe Ohrit, përfaqësuesve të interesuar të sektorit të NVM-me u ofrohet mundësia e për tu ndihmuar në përgatitjen e aplikacioneve për miratimin e granteve nga Fondi për inovacion.

Sektorit të NVM-me u dërgohen informacione në lidhje me publikimet nga Ministria e ekonomisë në pjesën e mundësive për subvencionimin e tyre, mbështetjen e klasterit për bashkim dhe rritjes së konkurrencës në sektorin e industrisë përpunuese – zhvillimi i subjekteve të biznesit, zhvillimin e produktit dhe të tregut.

Në periudhën raportuese, subjektet juridike nga rajoni që janë të interesuara iu prezantuan mundësitë për financim përmes Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për konkurrues mërinë, sipërmarrjes dhe inovacionin për 2018, që synon kryesisht të stimulojë sipërmarrjen, si dhe përmes reklamave të Ministrisë së Ekonomisë për nxitjen e turizmit rural.

Sektori të NVM-ve u rregullisht iu plasohen informacione përkatës për thirrjet në kuadër të BE-së, kryesisht për programet Horizon 2020 dhe COSME.

Përmes postës elektronike, përfaqësuesit e sektorit të NVM-ve, odat e tregtisë, shoqatat dhe prodhuesit u informuan dhe u ftuan rregullisht për evenimente të organizuara nga Qendra për Zhvillimin e RPJP, si dhe nga institucionet në nivel qendror, rajonal dhe lokal, të cilat i referoheshin temave që i interesojnë komunitetit të biznesit.

Gjithashtu, është bërë azhurnimi i bazës elektronike të të dhënave duke zgjeruar listën e institucioneve që ofrojnë shërbime të caktuara për sektorin e NVM-ve në rajon.

Qendra për zhvillim, filloi përgatitjet për grumbullimin e ideve për realizimin e projekteve përmes fondeve të ofruara nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria e vetëqeverisjes lokal. Në këtë drejtim, sektori i NVM-ve u animua për të marrë pjesë aktivisht në punëtoritë dhe takimet e planifikuara, në të cilat do të shfaqen idetë e projektit që do të mbështesin aktivitetet e caktuara të komunitetit të biznesit, si dhe realizimin e një projekti të caktuar lidhur me Strategjinë për Inovacion.

Masa 1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim në sektorin NVM

Treguesit

- Numri i aktiviteteve për nxitjen e zhvillimit ekonomik në rajon

Rezultatet dalëse

- Organizimi i dy takimeve informative për 50 përfaqësues nga sektori i biznesit në rajonit planor Jugperëndimor
- Azhurnimi i të dhënave në bazën elektronike rajonale për institucionet dhe ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbime për zhvillimin e sektorit privatë
- Informimi i vazhdueshëm i sektorit të biznesit përmes postës elektronike
- Dy raporteve periodike të përgatitura për realizimin e aktiviteteve të projekteve dhe janë dërguar deri tek NVM.

2. Përgatitja e planeve urbanistike për vendbanimet – fshatra

Projekti është financuar përmes Programit për mbështetjen financiare për zhvillim rural për vitin 2015 përmes masës 322 Rindërtim dhe zhvillim të fshatrave. Për shkak të ndërlikimeve dhe procedurave gjatë realizimit të projektit, afatit kohor për mbarimin e projektit është vazhduar deri për datën 30.06.2019. Partnerë në këtë projekt janë Struga, Qendra Zhupë dhe Debërca për të cilat përgatiten plane urbanistike për fshatra në tetë vendbanime me sipërfaqe prej 491 hektar. Gjatë vitit 2018 u organizuan 4 takime me përfaqësues nga Qendra për zhvillim, komunat partnere dhe operatori ekonomik, ku u diskutua për detyrat për të gjithë pjesëmarrësit dhe dinamikën e aktiviteteve. Është përgatitur programi planor dhe janë azhurnuar të dhënat gjeodezike dhe janë kërkuar kushtet për planifikim hapësinor nga Agjencia për planifikim hapësinor. Për vendbanimet Llabunishtë dhe Kalishtë nga Struga pritet Vendim për kushtet për planifikim hapësinor. Për vendbanimet Orovnik dhe Gorenci (komuna e Debërcës) është korrigjuar përfshira planore në KPH, duke i vendosur sipërfaqet e mëparshme ose me mënjanimin e tyre nga përfshirja planore, ndërsa për Trebenishtën janë përgatitur Kushtet për përfshirjen planore nga ana e Agjencia për planifikim hapësinor dhe janë dërguar deri tek Ministra për mjedisit jetësor dhe planifikim hapësinor për përgatitjen e Vendimit për kushtet e planifikimit hapësinor për KPH për Trebenishtën.

Për vendbanimin Zhitineni (Komuna e Qendrës Zhupë), është miratuar programi planor, janë marrë kushtet për planifikim hapësinor, është përgatitur Propozim plani për fshat, është bërë anketa publike dhe prezantimi, dhe janë dorëzuar fletët anketuese. Plani ndodhet tek Komisioni për përgatitjen e raportit për anketën publike dhe prezantim. Për vendbanimin Balanci nga e njëjta komunë, është dërguar kërkesë deri tek Qendra nacionale për konservim të japin mendim dhe pritet përgjigje nga ana e tyre.

Deri në fund të afatit duhet të përgatitet Strategjia për vlerësim për ndikimin në mjedisin jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve, tjetërsim i tokës nga tokë bujqësore në ndërtimore, dhe përputhje digjitale në AKN dhe regjistrimi i të njëjtës.

Masa 1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim e strukturate hapësinore funksionale

Rezultatet dalëse

- Organizimi i katër takimeve me përfaqësues nga komunat partnere
- Kushte për planifikim hapësinor të përpunuara nga APH dhe dërgimi i tyre në MMHPP për tre vendbanime
- Marrja e Kushteve për planifikim planor për dy vendbanime
- Janë bërë korrigjime të përfshirjes planore në dy vendbanime

- Është përgatitur Propozim plan për fshatra, është bërë anketë publike dhe prezantimet dhe janë dërguar letrat anketuese për një vendbanim

2. Plotësimi i dokumentacionit teknik për rrugicat për këmbësor dhe biçikleta prej Qendrës Zhupë – ishulli i Dibrës – krahu1

Për nevojat e komunës Qendër Zhupë është bërë plotësimi i dokumentacionit teknik për rrugicat për këmbësor dhe biçikleta prej Qendrës Zhupë deri në ishullin e Dibrës me gjatësi prej 775m. Plotësimi është bërë për rregullimin e hapësirës në plazhin e paraparë me përmbajtjet përkatëse për këtë lloj të objekteve turistike. Dokumentacioni i plotësuar u shfrytëzuar nga ana e komunës së Qendrës Zhupë për të konkurruar për mjete financiare në Bankën Botërore përmes projektit Konkurrencë lokale dhe rajonale. Janë bërë plotësime tek Projekti Bazikë për ndërtimin e rrugicës për këmbësor dhe biçikleta, projektin infrastrukturor, revizionin, Elaboratin për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe në Elaboratin për përcaktimin e sinjali stikës të komunikacionit.

Masa 1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Plotësimi i Projektit Bazikë dhe Revizionit

- Plotësimi i projektit infrastrukturor

- Plotësimin e Elaboratit për mbrojtjen mjedisit jetësor

- Plotësimin Elaboratin për përcaktimin e sinjali stikës të komunikacionit

4. Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturën rrugore në RPJP

Me projektin është përgatitur dokumentacion teknik – projekte bazike dhe infrastrukturore me gjithë revizion, për rekonstruksin e pesë rrugëve lokale, për ndërtimin e një rruge lokale, për rekonstruksin dhe ndërtimin e dhjet rrugëve lokale dhe për kanalizim fekale dhe atmosferik për dy rrugë. Partnerë në projekt janë pesë komuna nga rajoni planor Jugperëndimor: Struga, Ohri, Vevçani, Debrca dhe Kërçova. Projekti u realizuar me mbështetje financiare nga Programi për zhvillim të barabartë rajonal nga Ministria për vetëqeverisje lokale dhe Byroja për zhvillim rajonal për vitin 2018.

Në kuadër të projektit është përgatitur dokumentacion teknik për rrugët e mëposhtme:

Rekonstruksin i rrugës lokale nga f. Trebenishtë deri tek f. Misleshovë (krahu 1 dhe krahu 2);

Rekonstruksin i rrugës lokale nga f. Mesheisht deri tek manastiri Shën. Ilija (krahu 1 dhe krahu 2);

Rekonstruksin i rrugës lokale nga f. Mesheisht deri f. Volin;

Rekonstruksin i rrugës lokale deri në f. Zlestit; Ndërtimi i rrugës lokale nga Kërçova (vendbanimi Biçinci), f. Mamudovci deri tek f. Strellci;

Rekonstruksin dhe zgjerimi i rrugës lokale nga f. Strellci deri tek f. Shutovo; Ndërtimi i rrugës grumbulluese “ C 2” nga rruga “Turistička” deri tek rruga “Partizanska”, Komuna e Strugës.

Rekonstruksin i rrugës 7 Nëntori në komunën e Ohrit; Rekonstruksin i rrugës Abaz Emin në komunën e Ohrit; Rekonstruksin dhe ndërtimi i rrugëve: Aluloj – Gogoj, Rusej – Burimet e Vevçanit, Murxhej-Drenje, Qitanoj2, Kostojçini 3, Qezhoj 1, Daskaloj 1 në komunën e Veçanit; Ndërtimi i kanalizimit atmosferik për rrugën në pjesën UE 8 rruga grumbulluese C 2 me gjatësi prej 422m, rruga C 2 me gjatësi prej 810 m në qytetin e Strugës; Ndërtimi i kanalizimit fekale për rrugën në pjesën UE 8 – rruga grumbulluese C2 me gjatësi prej 422m, rruga Partizanska me gjatësi prej 1200m në Strugë;

Për realizimin e këtyre aktiviteteve u realizuar furnizim publikë i hapur dhe i ndarë, me çka operatori ekonomik i zgjedhur i përgatiti projektet bazike dhe infrastrukturore, ndërsa një firmë e licencuar dhe e pavarur bëri revizionin e të njëjtave.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara
- Gjatësia e rrugëve të projektuara, lagjeve dhe kanalizimit

Rezultatet dalëse

- Përgatitja dhe realizimi i 1 furnizimi publik të hapur dhe i ndarë me pjesë për zgjedhjen e operatorit ekonomik për projektim dhe revizion
- 12 projekte infrastruktura të përgatitura
- 12 projekte bazike të përgatitura
- U bë revizioni i 12 projekteve infrastrukturore dhe 12 projekteve bazike
- U përgatiten 12 elaborate gjeodezike dhe 12 elaborate për mjedisin jetësor
- Rrugë të projektuara për rekonstrukcion me gjatësi prej 11.330 m
- Rrugë të projektuara për ndërtim në gjatësi prej 3.650 m
- Rrugë të projektuara në gjatësi prej 1.417 m
- Rrugë të projektuara për rekonstrukcion nga gjatësi prej 1.787 m
- Projektimi i kanalizimit atmosferik në gjatësi prej 1.654 m
- Projektimi i kanalizimit fekale në gjatësi prej 1.622 m

5. Ndërtimi dhe rekonstrukcioni i infrastrukturës rrugore

Projekti ka bërë përmirësime në infrastrukturën rrugore përmes rindërtimit të dy rrugëve ekzistuese dhe përmirësimit të infrastrukturës turistike nëpërmjet ndërtimit të një vendkalim këmbësorësh. Partnerët në projekt janë tre komuna: Ohër, Makedonski Brod dhe Qendra Zhupë, dhe aktivitetet e projektit u mbështeten financiarisht përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për 2018 nga Ministria e vetëqeverisje lokal dhe Byroja për zhvillim rajonal.

Në kuadër të projektit u realizuan aktivitetet e mëposhtme: Koordinimi dhe menaxhimi i projektit; Përzgjedhja e konsulentëve për specifikimin teknik dhe vlerësimin e ofertës; Procedurat e tenderit (2); Përzgjedhja e autoriteteve mbikëqyrëse (3); Rikonstrukcioni i një rruge në Makedonski Brod; Rindërtimi i një rruge në vendbanimin Balanci, Qendra Zhupë; Ndërtimi i një rruge për këmbësorë në Ohër; Vendosja e ndriçimit elektrik në një vendkalim këmbësorësh në Ohër; U përgatit një elaborat për e.e. në një vendkalim këmbësorësh në Ohër; Raportet nga organi mbikëqyrës (3); Lëshimi në përdorim i objekteve; Dokumentacioni i përgatitur - raportet përfundimtare - tek BZHR / MVL;

Komunat partnere në projekt në pjesën për bashkëfinancim siguruan organin mbikëqyrës, dhe mjete financiare, për shkak se u paraqiten mungesa gjatë realizimit të projektit, gjegjësisht pas realizimit të tenderit dhe nënshkrimit të marrëveshjes me operatorin ekonomik.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara
- Gjatësia e rrugëve dhe rrugicave të re konstruktuar/rrugë dhe rrugica të ndërtuara
- Numri i kandela brave të vendosura

Rezultatet dalëse

- Përgatitja dhe realizimi i dy furnizimeve publike për përzgjedhjen e operatorit ekonomik
- Zgjedhja e konsulentit dhe organin mbikëqyrës
- Elaborat i përgatitur për rrugica për këmbësor
- 3 Raporte nga organi mbikëqyrës
- Lëshimi në përdorim i 3 objekteve
- Përgatitja e 3 raporteve finale
- Rekonstruktimi i rrugës në gjatësi prej 1.681, 93 m në Makedonski Brod dhe Qendër Zhupë
- U bë tamponimi i krahut në rrugën 1 në vendbanimi Balanci me gjatësi prej 215m
- Raport për rrugicën për këmbësorët në gjatësi prej 324,82 m në komunën e Ohrit
- Vendosija e ndriçimit elektrik në 20 kandelabra në rrugicën për këmbësorë në Ohër

Qëllimi afatmesëm 2

Arsim i përshtatur për nevojat e zhvillimit ekonomik, mbrojtja sociale dhe shëndetësore, për popullsinë në rajon dhe krijimi i kushteve për parandalimin e migracionit

6. Dekada e përkatësisë – Festimi i dallimeve

Projekti është realizuar nga shoqata joqeveritare LDA Strugë në bashkëpunim me komunat e RPJP dhe është i financuar nga ana e Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i projektit është që të kontribuohet në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike përkatësisht në rajonin Jugperëndimor përmes fuqizimit të bashkëpunimit mes sektorit civil, dhe sektorit publik dhe privat dhe komisionit për marrëdhëniet me bashkësitë.

Implementimi i projektit u realizuar në tre faza. Në fazën e parë aktivitetit ishin me karakter të hapur dhe u realizuan 10 iniciativa lokale të cilat u gjeneruan gjatë takimeve dhe komunikime me të gjithë palët e interesuara. Në fazën e dytë u realizuan projekte për fuqizimin e kapaciteteve të Komisionit për marrëdhënieve të bashkësive të cilat veprojnë në kuadër të komunave. Gjithashtu u bë hulumtim të mendimit publik për Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Faza e tretë e projektit ishte dedikuar për fuqizimin e sektorit qytetar përmes implementimit të Programit për rigrantim. Në kuadër të kësaj Programe u mbështeten 16 organizata më të vogla lokale nga rajoni Jugperëndimor të cilat me sukses realizuan një sërë aktivitetesh në bashkësitë e tyre. Gjithashtu u realizuar edhe ndërmjetësimi i organizatave për tua lehtësuar projektin dhe menaxhimin me mjetet financiare dhe u rriten kapacitete e organizatës në qëllimet e tyre strategjike. Aktivitete nga projektet kishin ndikim pozitiv mbi fuqizimin e organizatave qytetare dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike. U krijuan aleanca të qëndrueshme, kreative dhe të shumëllojshme mes politikanëve, sektorit të biznesit dhe atij civil me qëllim për krijimin e shoqërive multi- etnike gjithëpërfshirëse.

Masa 2.2.2 Përfshirja e kuadrit lokal të arsimuar dhe profesional në planifikimin dhe krijimin e perspektivave të zhvillimit në Rajonin dhe mjedisin e tyre

Treguesit

- Numri i dokumenteve, evenimentet e organizuara

Rezultatet dalëse

- Organizimi i 104 evenimenteve
- U realizuan dhjet iniciativa lokale
- Evenimente të organizuara, udhëtim studimor për Komisionin për marrëdhënie mes bashkësive
- Mbështetje për 16 organizata lokale përmes rigrantimit

7. Përshatja e objekteve me energji efikase në RPJP – kopshte për fëmijë

Projekti është financuar përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim Rajonal për vitin 2018. Qëllimi kryesor i projektit është zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike dhe ngrohjes duke zëvendësuar dritaret, dyert, instalimin e izolimit termik, vendosjen e rrjetit të rrymës, rindërtimin e çatisë në dy godina për fëmijët parashkollorë në rajon.

Në IPKKF “8 Marsi – Flutura” në Strugë u vendosen PVC dritare dhe dyer të reja, u bë izolimi i tavanit, u vendos izolimi termik, u vendos rrjeti i ri elektrik, u montuan drita LED, u montuan radiator dhe u vendosen pllaka qeramike në kuzhinë.

Në Komunën e Ohrit u bë rekonstruktim pullazit në IPKKF “Razvigorçe”. U demontua llamarina e vjetër, u vendos mbulesë e re prej llamarinës të plastifikuar, janë instaluar shtresa të reja me një gjerësi prej 415 mm deri në 730 metra, janë instaluar mbrojtëse bore, është bërë instalimi i një kanali të fshehur dhe janë vendosur mbulesa prej llamarine. Në një pjesë të pullazit u vendos nën konstruksion prej druri, në pajtueshmëri me projektin teknik.

Gjatë realizimit të aktiviteteve të caktuara, komunat partnere kanë siguruar mbikëqyrësin. Nga fillimi i korrikut deri në mes të nëntorit 2018, u përfunduan aktivitetet për ndërtim dhe objektet e rinovuar u lëshuan në përdorim. Realizimi i aktiviteteve të projektit në dy kopshtet e përmendura në rajon do të reduktojë ndjeshëm konsumin e energjisë dhe gjithashtu edhe shpenzimet e këtyre institucioneve. Gjithashtu, në masë të madhe janë përmirësuar kushtet për qëndrimin e fëmijëve, funksionaliteti i objekteve është përmirësuar dhe emetimet e gazrave janë ulur.

Masa 2.3.2 Rritja e përfshirjes së familjeve dhe individëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje sociale

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim / rekonstruktim të objekteve
- Sipërfaqja dhe gjetësit e intervenimit

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion për tenderim i përgatitur, u realizuan dy procedura tenderimi
- U zgjodhën organet mbikëqyrëse nga ana e komunave dhe të njëjtin kyçën në punë
- U ndruan PVC e vjetra – 145 dritare dhe dyer
- U realizuar izolimi i tavanin me sipërfaqe prej 265m²
- U vendos izolim termik me sipërfaqe prej 246m²
- U vendos elektrik e re me sipërfaqe prej 226m²
- U montuan 40 poçe LED dhe 2 radiator
- U vendosen 7m² pllaka qeramike
- U demontua pullazi i vjetër në sipërfaqe prej 1735m²
- U montua llamarinë e plastifikuar në sipërfaqe prej 1735m²
- U vendosen mbrojtëse në pullaz në gjatësi prej 730m
- u vendosen mbrojtëse bore në gjatësi prej 215 m
- u vendos ulluk i fshehur në gjatësi prej 75m
- u vendosen kapak llamarine me gjatësi prej 156m

- u vendos nen konstrukcion prej druri në gjatësi prej 8,1m 3 dhe pengesa prej druri prej 880m

Qëllimi afatmesëm 3

Zhvillimi i turizmit i ndërlidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore në rajonin planor

8. Përmirësimi i Android GIS aplikacionit për trashëgimin natyrore dhe kulturore

Gjatë vitit të kaluar u punua në zgjerimin e modulit të **Android GIS aplikacionit ("SW Macedonia Attractions") për trashëgimin kulturore dhe natyrore të rajonit Jugperëndimor**, e cila u fillua dhe u realizuar si masë pilot nga Strategjia për inovacione. Nëpërmjet konsultimit me palët e interesuara në rajon (në kuadër të fondeve të kursyera nga marrëveshje me Zyrën e UNDP-së-Shkup) u ra dakord që në aplikacion të shtohen modulet "Kalendar i evenimenteve" dhe "Transporti im", si dhe të përmirësohet funksionaliteti dhe mundësit teknike për shfrytëzim më të mirë nga përdoruesit e final.

Versioni i ri i plotësuar, në marrëveshje me kompaninë (GDi NET-Shkup) e cila e punoj aplikacionin, u prezantua në një ngjarje madhore në Shkup në muajin shtator 2018, evenimenti u organizua nga vet ato dhe ndër të tjera u prezantuan pikat inovative nga fusha të ndryshme të jetës shoqërore.

Ky aplikacion mobil është pajisje e dobishme për të gjithë mysafirët në rajonin Jugperëndimor sepse të gjithë atraksionet turistike mund ti gjejnë në një vend.

Masa 3.1.4 Sigurimi i informacioneve, sinjalizimit dhe vizuale të atraksioneve turistike

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Organizimi i dy takimeve konsultative

- U shtuan dy module të reja në aplikacion

- U përmirësua funksionaliteti teknik i aplikacionit

- U bë prezantimi i aplikacionit në eveniment final në Shkupë para 350 pjesëmarrësve

9. E – sistem për menaxhimin me trashëgimin kulturore ndër rajonale

Projekti realizohet nga komuna e Ohrit në bashkëpunim me qytetet partnere të cilat janë nën mbrojtjen e UNESCO. Mbështetja financiare është siguruara përmes Programit EU INTERREG BalkanMed. Aktiviteti kryesor i projektit është digjitalizimi i trashëgimisë kulturore në katër lokacione të cilat janë nën mbrojtje të UNESCO. Gjatë vitit 2018 u nënshkrua Marrëveshja për partneritetet dhe Marrëveshja me Donatorin. Janë realizuar aktivitetet përgatitëse për fillimin e projektit. Është mbajtur takimi fillestar në Qipro për planifikimin dhe realizimin e buxhetit të projektit. Është përgatitur dokumentacioni specifik për disa aktivitete të projektit. Është mbajtur takim punues në Qipro për pyetjet në lidhje me financat dhe konkretizimi i aktiviteteve për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore tek çdo partnerë në veçanti. Është formuar bordi koordinues i projektit në të cilën morën pjesë të gjithë partnerët.

Masa 3.1.4 Sigurimi i informacioneve, sinjalizimit dhe vizuale të atraksioneve turistike

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- 2 marrëveshje të nënshkruara
- Është mbajtur takim fillestar për fillimin e projektit
- Janë përgatitur 5 specifikim teknike për aktivitetet e projektit
- Është mbajtur 1 takim punues
- Është formuar bordi koordinativ

10. Promovimi i turizmit përmes kulturës dhe ujit

Projekti realizohet nga ana e komunës së Strugës në partneritet me komunën e Strumicës nga rajoni Juglindor dhe me partnerë nga Greqia. Mbështetja financiare është siguruar përmes Programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Maqedonisë dhe Greqisë.

Aktivitetet kryesore të projektit janë: Vendosija e dy info-kabinave për turizëm; Pjesëmarrje në panair ndërkombëtar; Trajnimi i 80 personave në fushën e hotelerisë dhe organizimi i panairove lokale. Gjatë vitit 2018 departamenti projektues në komunën e Strugës punoi në përgatitjen e aktiviteteve paraprake dhe organizoj disa takime pune. Implementimi i aktiviteteve të projektit priten që të realizohen gjatë vitit 2019.

Masa 3.3.2 Brendimi i turizmit rajonal

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Aktivitete parapërgatitore 7
- 3 takime pune

Qëllimi afatmesëm 4

Mbrojta e cilësisë së ambientit jetësor

11. Furnizimi i mjeteve speciale për grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e rrugëve

Këtë projekt e realizoi komuna e Ohrit me mjete nga Banka Botërore përmes linjës kreditore MSIP. Gjegjësisht, për nevojat e ndërmarrjes komunale “Komunalja e Ohrit” janë furnizuar 7 mjete speciale për grumbullimin e mbeturinave. Me këtë do të përmirësohen shërbimet që ndërmarrja komunale i jep qytetarëve, dhe njëkohësisht në komunën e Ohrit sigurohet ambient jetësor më i pastër.

Masa 4.1.2 Vendosija e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturinat inerte

Treguesit

- Dokumente, evente, pajisje

Rezultatet dalëse

- Përgatitja e dokumentacionit tenderik dhe hulumtimi i tregut
- Realizimi i procedurës tenderike për furnizimin e mallrave
- Furnizimi i 7 automjeteve speciale për grumbullimin e mbeturinave
- Regjistrimi dhe vendosja në funksion i automjeteve

12. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për vendosjen e sistemit të integruar dhe të vete qëndrueshëm për menaxhim me mbeturina në rajonin e Pellagonisë, Jugperëndimor, Vardarit dhe Shkupit

Projekti është iniciuar nga Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, në kuadër të IPA dhe realizohet nga ana e operatorit ekonomik – konzorciumi ENVIROPLAN S.A. (udhëheqës) – LOUIS BERGER, BiPRO GmbH, EPEM S.A., SLR Consulting Ltd. Dokumentacioni i planifikuar u përgatit deri në fund të vitit 2017.

Gjatë vitit 2018 u komentua në raport me dokumentacionin e përgatitur dhe veçanërisht u morën parasysh kërkesat e komunës së Debërcës. Gjegjësisht nga ana e anëtarëve të Këshillit për zhvillim u kërkua që të shqyrtohet mundësia për ndërtimin e deponisë rajonale në lokacion tjetër. Në ndërkohë Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor filloi me aktivitete për sensibilizimin e banorëve në disa rajone dhe gjithashtu edhe në rajonin planor Jugperëndimor.

Sipas dokumentacionit të përgatitur dhe përlogaritjeve të bëra për ndërtimin e sistemit për menaxhim të integruar me mbeturinat në rajonin planor Jugperëndimor do të nevojiten rreth 40 milionë Euro.

Masa 4.1.2 Vendosja e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina inerte

Treguesit

- Dokumente, evente

Rezultatet dalëse

- Diskutim në Mbledhjen e Këshillit për zhvillim të RPJP

- Vizita në terren dhe prezantime në medime nga ana e MAJPH për sensibilizim

13. Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtimin e sistemit për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në Kërçovë

Projektin e kordinonte Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Maqedoni dhe Komuna e Kërçovës, ndërsa financiarisht mbështetej nga Komponenti IPA3 për zhvillim rajonal. Deri në fund të vitit 2017 operatori ekonomik i përzgjedhur - kryerësi dhe nënkryerësi, sipas dinamikës së planifikuar e përfunduan ndërtimin e sistemit për bartjen dhe trajtimin e ujërave të zeza në pjesën urbane të Kërçovës. U ndërtua dhe u montua stacioni pastrues për 32.000 banorë me mundësi për shtimin e moduleve në fazën e dytë deri në 60.000 banorë dhe janë vendosur dhe lidhur kolektorë në gjatësi prej 9 km. Në fillim të vitit 2018 Komuna e Kërçovës e ndërtoi rrugën qasëse deri te stacioni pastrues, dhe në mars të vitit 2018 sistemi u lëshua në përdorim.

Masa 4.1.3 Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese

Treguesit

- Tërësitë e ndërtuara, evente

Rezultatet dalëse

- Rruga qasëse e ndërtuar deri te SPUZ

- Organizimi i ceremonisë për lëshimin në përdorim të sistemit

14. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP

Projekti është i financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2018. Qëllimi kryesor i projektit është ulja e shpenzimeve për energji për ngrohje dhe elektrike përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së hidroizolimeve, vendosjes së termoizolimeve, vendosja e termo-fasadës, rikonstruktimi i konstruksionit të pullazit dhe mbulimi i pullazit në dy objekte publike në rajon.

Në objektin publik në Kërçovë në pronësi të komunës u bë rikonstruktimi i fasadës së jashtme. Gjatë kësaj u bënë këto intervenime: lyerja me mallter i pjesëve të dëmtuara të mureve ekzistuese; punimi i demit fasadës; punimi i parapetëve nëpër ballkone; përpunimi i pjesëve rreth dritareve dhe dyerve; punimi i këndeve rreth dritareve. Me termo fasadën e përpunuar do të kursehen 50% të energjisë për ngrohje dhe do të përmirësohen kushtet e punës për 185 të punësuar në komunë.

Në komunën e Debërcës u bë sanimi dhe rikonstruktimi i objektit të bashkësisë në f.Volinë. Gjatë asaj u kryen këto punë: demontimi i pullazit ekzistues nga qeramidhet; prishja e tavaneve ekzistues nga kallamet; prishja e dysHEMEVE; demontimi i dyerve dhe dritareve ekzistuese; betonimi i dysHEMEVE; betonimi i trotuareve; lyerja me mallter e mureve të brendshme; rregullimi i tavaneve; riparimi i pjesëve të dëmtuara të fasadës; përpunimi i pullazit me dërrasa; mbulimi i pullazit me qeramidhe; termoizolimi i dysHEMEVE; termoizolimi i pllloçës së pullazit; vendosja e dyerve dhe dritareve; përgatitja e ulluqeve jorizontale dhe vertikale; montimi i pllakave qeramike në dysHEME dhe mure; lidhja elektroenergjetike; instalim elektrik për ndriçim; ujësjellës sanitar; kanalizim fekal; sanitari.

Me rikonstruktimin e kryer do të ketë kursime të konsiderueshme në energjinë për ngrohje, dhe janë krijuar kushte për shfrytëzimin e objektit nga ana e 462 banorëve në f.Volinë.

Masa 4.2.2 Cilësia e ajrit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin/rikonstruktimin e objekteve, hapësira, gjatësia

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion tenderik i përgatitur, furnizime publike të realizuara
- Organet mbikëqyrëse të zgjedhura nga ana e komunave dhe vendosja në punë
- Termo izolimi i vendosur në pullaz 168 m² dhe në dysHEME 145 m²
- Dërrasa të montuara në kulm 292 m² dhe mbulimi me qeramidhe 292 m²
- Ulluqe të përpunuara dhe të montuara horizontale dhe vertikale në gjatësi prej 95m
- U krye sanimi i tavaneve me hapësirë prej 146 m² dhe janë vendosur tavane prej 146 m²
- Lyerja me mallter i mureve të brendshme me hapësirë prej 114 m²
- Betonimi i trotuareve 96 m²
- Vendosja e pllakave të qeramikes në mure dhe dysHEME me hapësirë prej 190 m²
- Ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra me PVC të reja - 25 copë
- U vendos instalim elektrik, ujësjellës, kanalizim dhe sanitari
- Rregullimi i pjesëve të dëmtuara të fasadës 240 m²
- Lyerja me mallter dhe rregullimi i pjesëve të dëmtuara të mureve 281 m²
- Përpunimi i demit fasadës 1403 m²
- Përpunimi i parapeteve në ballkone 84 m²
- Përpunimi i hapësirave rreth dyerve dhe dritareve në fasadë 815 m²
- Përpunimi i këndeve rreth hapjeve 257 m²

Nga shuma e përgjithshme e aktiviteteve të ndërmarra në këtë sferë konstatohet se 132 kanë qenë të ndërlidhura me qëllimin afatmesëm e parë nga Programi për zhvillim të rajonit planor, me qëllimin afatmesëm të dytë janë të ndërlidhur 151 aktivitete, me qëllimin afatmesëm të tretë 25 aktivitete, dhe me qëllimin afatmesëm të katërt 50 aktivitete nga Programi për zhvillim.

Duke i mbledhur aktivitetet e realizuara duhet të theksohet se janë realizuar gjithsej 358 aktivitete në të gjitha katër qëllimet afatmesme nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

PASQYRË TABELARE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË VITIN 2018 DHE LIDHJA E TYRE ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteve
I.RRITJA EKONOMIKE			
PRIORITETET			
1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale	1.1.1 Lidhja e institucioneve arsimore dhe kërkimore		
	1.1.2 Rritja e kapaciteteve për inovacion të ndërmarrjeve		
	1.1.3 Rritja e kapaciteteve për fondet përkatëse të shtetit dhe BE		
	1.1.4 Mundësitë për investime në TIK		
	1.1.5 Brendimi i Rajonit dhe produkteve të tij primare		
1.2 Tërheqja e investimeve	1.2.1 Mapimi i potencialeve të rajonit për investime		
	1.2.2 Promovimi i potencialeve ekonomike		
1.3 Përforcimi i sektorit të NVM	1.3.1 Përforcimi i kapaciteteve të NVM		
	1.3.2 Mbështetje për start-up bizneset		
	1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim të NVM	Takime punuese, azhurnimi i të dhënave, raporte	21
	1.3.4 Përparësitë për zejet tradicionale		
	1.3.5 Mbështetje për shfaqje të përbashkët të firmave		
1.4 Bujqësi dhe zhvillim rural	1.4.1 Përmirësimi i kualitetit dhe ofertës së produkteve bujqësore		
	1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural	Takime pune, elaborate, vërtetime në PUF, revizione, dokumentacion tenderik, punë, plotësimi i dokumentacioneve teknike	22
1.5 Zhvillimi i infrastrukturës komunikuese dhe transportit	1.5.1 Ndërtimi dhe modernizimi i rrjetit të trafikut	Procedura tenderike, përgatitja e projekteve bazike dhe infrastrukture, revizion, punë	89
	1.5.2 Zbatimi i TIK		

			132
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
II.ARSIMI DHE ZHVILLIMI SOCIAL PRIORITETET 2.1 Arsim kualitativ	2.1.1 Promovimi i përparësive të AMP		
	2.1.2 Krijimi i kushteve për paralele për AMP		
2.2 Përfshirja deri te tregu i punës për personat nga grupet e rrezikuara	2.1.3 Promovimi i biznesmenëve të suksesshëm		
	2.2.1 Iniciativa për mjediset rurale		
2.3 Programet sociale	2.2.2 Përfshirja e kuadrit të ekspertëve në planifikim	Evenimente, iniciativa lokale, udhëtime studimore, regrantimi i organizatave lokale	131
	2.2.3 Barazia gjinore dhe përfshirja e grupeve të rrezikuara në tregun e punës		
	2.3.1 Rritja e përfshirjes së mbrojtjes sociale		
	2.3.2 Përfshirja e fëmijëve në kopshte në zonat rurale	Procedura tenderike, vendosja e pllakave, ndërrimi i dritareve dhe dyerve, izolim termik, elektrik, llamarin e plastifikuar, mbrojtje bore, konstruksion druri, ulluqe	20
	2.3.3 Programe për mbrojtje të personave të moshuar, rrjet për		

	<i>mbrojtje shëndetësore</i>		
			151
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
III.ZHVILLIMI I TURIZMIT PRIORITETET 3.1 Zhvillimi i infrastrukturës	3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik planor		
	3.1.2 Shtigjet malore dhe rrjetëzim me rajonet tjera		
3.2 Përforcimi i kapaciteteve për zhvillim të turizmit	3.1.4 Info, sinjalizim dhe vizuelizim i atraksioneve turistike	Takime konsultative, plotësimi i moduleve të reja, prezantim, marrëveshje, takime, specifikacion teknik	15
	3.1.5 Revitalizimi dhe ndërtimi i objekteve në zonat rurale		
	3.1.6 Ndërtimi, revitalizimi i shtëpive malore		
	3.2.1 Sistem për organizim turistik për rajonin		
	3.2.2 Trajnime për ngritjen e kapaciteteve		
	3.2.3 Përmirësimi i punës së klasterëve dhe shoqatave		
	3.2.4 Vendorsja e sistemit për evidentim të turistëve		
	3.2.5 Krijimi i klimës për PPP		
	3.2.6 Sistem për menaxhimin e destinacioneve		
	3.3 Krijimi i ofertës turistike rajonale	3.3.1 Azhurnimi i hartave turistike	
3.3.2 Brendimi i rajonit		Aktivitete parapërgatitore, takime pune	
3.3.3 Produktet turistike - miks			
3.3.4 Zhvillimi i ofertës gastronomike			
3.3.5 Prodhime nga turizmi kulturor			
3.3.6 Rritja e konkurrencës			

	3.3.7 Promovimi i vlerave turistike		
			25
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteve
<u>IV.MBROJTJA E KUALITETIT TË AMBIENTIT JETËSOR</u> PRIORITETET 4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale Qëllimi afatmesëm	4.1.1 Rikonstruktimi dhe modernizimi i sistemeve të ujësjellësit		
PRIORITETET 4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale	4.1.2 Sistem i integruar për menaxhim me mbeturinat inerte	Procedura tenderike, furnizim i mjeteve për mbeturina, dokumente strategjike, punëtori, vizita në terren, prezantime	21
	4.1.3 Sisteme për ujërat e zeza komunale	Ndërtimi i rrugëve me qasje deri SPUZ, lëshimi në punë i SPUZ	3
4.2 Mbrojtja e biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës	4.2.1 Mbrojtja e biodiversitetit		
	4.2.2 Kualiteti i ajrit	Procedura tenderike, vendosja e termo fasadës, hidro izolim, rikonstruktim, sanim, pllaka, ndërrim i dritareve, termo fasadë	26
	4.2.3 Mbrojtja e ujit dhe tokës		
			50
GJITHSEJ AKTIVITETE TË REALIZUARA			358